

URDHËR
Nr.4211/2, datë 12.7.2007

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.4211, DATË 7.6.2007 “MBI MASAT PËR
PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË QARKULLIMIT TË MJETEVE TË TRANSPORTIT
TË MALLRAVE, GJATË SEZONIT TURISTIK”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministri i Brendshëm

URDHËROJNË:

Pika 2 e urdhrit nr.4211, datë 7.6.2007 ndryshon si më poshtë:

2. Pezullimi i qarkullimit të bëhet në segmentet rrugore kombëtare, si:

a) Shkodër-Velipojë,

b) Vlorë-Himarë-Sarandë-Butrint.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani